

SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”,i ndryshuar, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Bashkia e Elbasan shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira të punës :

- *Mësues ndihmës pranë stafit arsimor dhe ndihmës pranë Drejtorisë së Politikave të Arsimit , Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit*

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- 1) Të jetë shtetas shqiptar;
- 2) Të ketë arsim të mesëm /lartë
- 3) Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- 4) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- 5) Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1) Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- 2) Curriculum Vitae;
- 3) Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- 4) Çertifikatë e përbërjes familjare;
- 5) Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- 6) Fotokopje e librezës së punës;
- 7) Raport mjeko-ligjor;
- 8) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- 9) Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm)

Dokumentat e përmendura me sipër , duhet të dorëzohen pranë Bashkisë Elbasan në Drejtorinë e Administratës, Burimeve Njerëzore dhe Monitorimit të Performancës , me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur të bëhet brenda date 18.09.2023

KUJDES: KJO SHPALLJE DO TË PUBLIKOHET NË STENDAT E INFORMIMIT QYTETAR DHE NË FAQEN ZYRTARE TË WEB TË BASHKISË ELBASAN.